

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E RAHOVECIT OPSTINA ORAHOVAC MUNICIPALITY OF RAHOVEC	
---	--	---

Për:	Grup i Operatorëve Ekonomik: “Cimi @ ELECTRONIC” SH.P.K. & “IMPACT” SH.P.K. – Dega në Kosovë – Skenderaj Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	25.06.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **Kërkesës për Rishqyrtim**, të datës: **22.06.2021**, të parashtruar nga Grup i Operatorëve Ekonomik: **“Cimi @ ELECTRONIC” SH.P.K. & “IMPACT” SH.P.K. – Dega në Kosovë** me adresë në **Skenderaj**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **INSTALIMI I KAMERAVE NË SHKOLLA, OBJEKTE KULTURORE DHE SHTËPINË E TË MOSHUARVE NË KOMUNËN E RAHOVECIT**, me Numër të prokurimit: **623-21-1821-1-2-1**, Numër i brendshëm: **623-21-015-1-2-1**, nxjerr:

VENDIM

- I. **APROVOHET** si pjesërisht e bazuar kërkesa e parashtruar nga Grup i Operatorëve Ekonomik: **“Cimi @ ELECTRONIC” SH.P.K. & “IMPACT” SH.P.K. – Dega në Kosovë** me adresë në **Skenderaj**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **INSTALIMI I KAMERAVE NË SHKOLLA, OBJEKTE KULTURORE DHE SHTËPINË E TË MOSHUARVE NË KOMUNËN E RAHOVECIT**, me Numër të prokurimit: **623-21-1821-1-2-1**, Numër i brendshëm: **623-21-015-1-2-1**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK – së, të datës: **17.06.2021**, të publikuar në web – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- II. **ANULOHET** Vendimi i Autoritetit Kontraktues për aktivitetin e prokurimit: **INSTALIMI I KAMERAVE NË SHKOLLA, OBJEKTE KULTURORE DHE SHTËPINË E TË MOSHUARVE NË KOMUNËN E RAHOVECIT**, me Numër të prokurimit: **623-21-1821-1-2-1**, Numër i brendshëm: **623-21-015-1-2-1**, dhe i njëjti aktivitet i prokurimit të kthehet në **Ri-vlerësim**.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.